



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E RAHOVECIT - OPSTINA GRADCA  
Drejtoria e Punës së Inspekteve  
Drejtoria e Punës së Inspekteve

3311 21.10.24  
DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE  
RAHOVEC - GRADCA

# RAPORT NËNTËMUJOR I PUNËS DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE

JANAR - SHTATOR 2024

KOMUNA E RAHOVECIT

## **TABELA E PËRMBAJTJES**

<b>HYRJE.....</b>	<b>2</b>
<b>AKTIVITETET E INSPEKTIMEVE NË PËRMBUSHJEN E OBJEKTIVAVE.....</b>	<b>2</b>
<b>STATISTIKA – GJOBA MANDATORE DHE REALIZIM I TË HYRAVE .....</b>	<b>4</b>
<b>PËRFUNDIM.....</b>	<b>5</b>

## HYRJE

Raporti të cilin po e prezantojmë, pasqyron punën e Drejtorisë për Punë Inspektuese, për periudhën: janar – shtator të vitit 2024. Në këtë raport janë të përfshira punët dhe aktivitetet e kryera dhe të ndërmarra nga Drejtoria për Punë Inspektuese të cilat janë paraqitur sipas sektorëve të cilët i mbulojmë si dikaster. Inspektimet kanë për qëllim: Zbatimin e ligjeve dhe akteve tjera nënligjore, mbrojtjen e interesit të përgjithshëm publik dhe mbrojtjen e interesave të ligjshëm të subjekteve të inspektimit.

## AKTIVITETET E INSPEKTIMEVE NË PËRMBUSHJEN E OBJEKTIVAVE

Gjatë periudhës janar – shtator, në Drejtorinë për Punë Inspektuese, inspektimet janë realizuar në tërësi duke e mbuluar territorin e Komunës së Rahovecit, - DPI është organizuar në grupe inspektuese me nga 4 grupe të kombinuara sipas nevojës. Inspektimi në terren rregullisht fillon nga ora: 9:00: - 14:00, ndërsa sipas rrethanave dhe kërkesave mund të zgjasë edhe më shumë;

- Në total, gjatë kësaj periudhe raportuese janë realizuar 570 kontolle inspektuese. Krahas prioriteteve siç janë: Parandalimi i ndërtimeve pa leje, Lirim i Hapësirave Publike, Mbrotja e Mjedisit, Luftimi i Ekonomisë së Zezë, Mbrotja e Konsumatorit; prioritet dhe fokus i yni kryesor ka qenë mbrojtja e shëndetit të qytetarëve;
- 80 shfrytëzuesve të hapësirave publike, para lokaleve afariste u janë shpërndarë urdhëresa për tu pajisur me lejet përkësese për shfrytëzim të hapësirave publike, përkizazi me rregulloren komunale;
- Në angazhimet tona për luftë ndaj ekonomisë informale, për këtë periudhë raportuese, 47 është numri i bizneseve të reja të cilat janë regjistruar në zyrën e ARBK-së, pas urdhëresave nga shërbimi ynë;
- 47 është numri i lëshuar i pëlqimeve të punës, për subjektet afariste të cilat i kanë plotësuar kushtet higjienike – teknike;
- Janë inspektuar 66 biznese nga inspektorët e tregut lidhur me identifikimin e produkteve ushqimore me afat të skaduar, vendosjen e çmimeve në produkte etj;
- Është bërë verifikimi periodik i peshoreve në furrat e bukës;
- Në fushën e ndërtimit për këtë periudhë raportuese, sipas raportit të punës nga inspektori përkatës, janë inspektuar 90 objekte ndërtimore të kategorisë së parë, poashtu është bërë inspektimi i dokumentacionit teknik (projekti i ndërtimit, lejet e ndërtimit, janë shqiptuar 66 gjoba mandatore për ndërtim pa leje, si dhe janë obliguar që të pajisen me leje ndërtimore,, 54 janë pajisur me leje dhe 66 janë pajisur me kushte ndërtimore;

- Poashtu, në sektorin e ndërtimit është bërë përpilimi i procesverbaleve për gjendjen e punimeve në vend ndërtim, për respektimin ose mosrespektimin e kushteve të përcaktuara për ndërtim, dhënia e vendimit për ndërprerjen e punimeve ndërtimore deri në evitimin e parregullsive tekniko- procedural si dhe janë marrë vendime për ndërprerjen (pezullimin) e punimeve, deri në evitimin e parregullsive tekniko- procedural;
- Janë inspektuar edhe disa prej subjekteve afariste, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në komunën e Rahovecit, ku prej tyre është kërkuar pajisja me Leje Mjedisore, 23 prej tyre janë pajisur me leje mjedisore pas urdhëresave nga inspektori i mjedisit;
- Në fushën e transportit publik ne në vazhdimësi kemi përcjellur nga afér punën e kompanive të licencuara të autobusëve, se a janë duke i mbuluar mjaftueshëm dhe sigurtë linjat e transportit të udhëtarëve, në rendet e udhëtimit të cilat janë lëshuar nga organi kompetent komunal. Poashtu, janë kryer inspektime rutinore ku edhe janë urdhëruar autotaksi të bëjnë vazhdimin e lejes për kryerjen e transportit jo të rregullt të udhëtarëve.
- Janë trajtuar kërkesa të qytetarëve, kryesisht me problematika në sektorin e çështjeve komunale;
- Në funksion të mbrojtjes dhe ruajtjes së pronës publike është bërë rrënimi i një muri në qytetin e Rahovecit, një shtëpie në qytetin e Rahovecit, janë rrënuar edhe dy objekte në fshatin Xërxe, si dhe janë rrënuar dy objekte në fshatin Krushë e Madhe që të gjitha këto hapësira publike tashmë të lira për shfrytëzim nga qytetarët;

## STATISTIKA – GJOBA MANDATORE DHE REALIZIM I TË HYRAVE

LLOJI I NDËSHKIMIT	NUMRI I GJOBAVE TË SHQIPTUARA	VLERË E GJOBËS NË €
GJOBA MANDATORE PËR NDËRTIM PA LEJE	66	29,725.00€
GJOBA MANDATORE – ÇËSHTJE KOMUANLE	14	3200€
GJOBA MANDATORE PËR MOSRESPEKTIM TË ORARIT TË PUNËS	8	400 €
GJOBA MANDATORE PËR MJEDIS	31	2500 €
<b><u>TOTALI:</u></b>	<b><u>119</u></b>	<b><u>35,825.00€</u></b>


LLOJI I VEPRIMIT	NUMRI I KËRKESAVE	VLERË NË €
KËRKESA PËR KONTROLL INSPEKTUES	31	310 €
PËLQIME PUNE	47	705 €
<b><u>TOTALI:</u></b>	<b><u>78</u></b>	<b><u>1015 €</u></b>

<b><u>TOTALI I TË HYRAVE NË DPI :</u></b>	<b><u>JANAR – SHTATOR 2024</u></b>	<b><u>36,840.00€</u></b>
---	------------------------------------	--------------------------

## PËRFUNDIM

*Përkundër të gjitha sfidave, konsiderojmë që jemi në rrugë të mirë për përbushjen e të gjitha objektivave, sigurisht edhe me një bashkëpunim me të gjitha institucionet tjera të cilat po nahnihmojnë me arritjen e rezultateve konkrete.*

Nora BOSHNJAKU



Drejtoreshë për Punë Inspektuese